



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/119

Datë: 13.03.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike 03/L-087, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen rregullat për lartësinë e kompensimit të anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore sipas këtij kategorizimi:
 - 1.1. Kategoria I: PTK, KEK, KOSTT, KKDFE, dhe Posta e Kosovës;
 - 1.2. Kategoria II: Ibër Lepenc, InfraKos, TrainKos, ANP "Adem Jashari"-Kontrolli Ajror dhe KRU Prishtina;
 - 1.3. Kategoria III: Ndërmarrjet tjera të sektorit të ujësjellësit, ujitjes dhe mbeturinave.
2. Kompensimi i anëtarëve të bordeve të Ndërmarrjeve Publike bëhet sipas tabelës së bashkangjitur të këtij vendimi.
3. Shfuqizohet vendimi nr.05/140, i datës 18.08.2010.
4. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Kategoria	Pozicioni	Bordi i drejtoreve	Komisioni i Auditimit	Komitetet tjera	Komenti
Kategoria 1	Kryesues	850,00	200,00	150,00	
	Anëtar	750,00	150,00	120,00	
Kategoria 2	Kryesues	500,00	150,00	130,00	
	Anëtar	400,00	120,00	110,00	
Kategoria 3	Kryesues	320,00	120,00	110,00	
	Anëtar	270,00	100,00	90,00	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/119

Datë: 13.03.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2013, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike - Agjenda Digjitale për Kosovën për vitin 2013-2020.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Politikës nga pika 1. i këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/119

Datë: 13.03.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2013, mori:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohen shpronësimet dhe vlerësimet me interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i rrugës nacionale N9 Fushë-Kosove-Arllat-Gjurgjicë, Zona Kadastrale Komoran, Komuna Drenas, sipas tabelës të bashkangjitur këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës së pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/ MMPH në mbështetje të Kuvendeve Komunale në territorin e të cilave gjenden zonat kadastrale, i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/ MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat e bashkangjitura këtij vendimi në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilave i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim, subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues interesi, në pronën e

paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.

6. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi e vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është i detyruar të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazete me tirazh të madh në Kosovë.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/119

Datë: 13.03.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2013, mori:

V E N D I M

Për themelimin e komisionit punues për regjistrimin e bujqësisë

Neni 1

Qëllimi

Ky vendim përcakton strukturën organizative, fushë veprimtarinë dhe përbërjen e Komisionit Punues për regjistrimin e bujqësisë.

Neni 2

Fushë veprimtaria

Komisioni punues është organ ndërqeveritar i themeluar për të shqyrtuar çështjet që ndërlidhen me mbikëqyrjen e regjistrimit të bujqësisë.

Neni 3

Përbërja e Komisionit

1. Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:

- 1.1. Kryesues, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- 1.2. Zëvendës kryesues, Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- 1.3. Anëtar, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- 1.4. Anëtar Ministria e Financave;
- 1.5. Anëtar, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- 1.6. Anëtar, Ministria e Punëve të Brendshme;
- 1.7. Anëtar, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;

- 1.8. Anëtar, komuniteti serb;
- 1.9. Anëtar, komunitetet tjera;
- 1.10. Anëtar, Fakulteti i Bujqësisë;
- 1.11. Anëtar, Shoqëria Civile, dhe
- 1.12. Anëtar, Oda Ekonomike e Kosovës.

Neni 4 Përgjegjësia e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë të:
 - 1.1. Mbikëqyrë dhe monitoron përgatitjen dhe realizimin e regjistrimit;
 - 1.2. Lehtëson dhe garanton bashkërendimin e punës së ndërlidhur me regjistrimin ndërmjet ministrive, institucioneve dhe palëve tjera të përfshira në regjistrim;
 - 1.3. Jep mendime, propozon rekomandime dhe i nënshkruan me kohë sipas programit të punës, projektet e pyetësorëve për regjistrimin e përgatitur nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës;
 - 1.4. Analizon raportet e përgatitura nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës dhe problemet e ballafaquara gjatë procesit të operacioneve të regjistrimit dhe merr pjesë në mënyrë aktive në zgjidhjen e mungesave të mundshme, vonesave dhe problemeve tjera;
 - 1.5. Së bashku me Agjencioni i Statistikave të Kosovës e informon Qeverinë e Republikës së Kosovës rreth problemeve lidhur me operacionet e regjistrimit;
 - 1.6. Analizon rezultatet e regjistrimit të përkohshëm të përgatitura dhe dorëzuara për shqyrtim në Agjencioni i Statistikave të Kosovës;
 - 1.7. Jep mendimin për planin e përgjithshëm të punës të aktiviteteve të regjistrimit të përgatitura nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës;
 - 1.8. Jep mendime për fushatën e publicitetit;
 - 1.9. Rishikon planin e operacioneve të pilot regjistrimit dhe rezultateve të raportuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës si dhe në anketën pas regjistrimit;
 - 1.10. Rishikon planin e tabelimit, përpunimit të të dhënave dhe programin e përhapjes së të dhënave;
 - 1.11. Komisioni takohet çdo tre (3) muaj që nga momenti i funksionimit të tij ose më shpesh sipas nevojë. Në raste të veçanta anëtarët e komisionit këshillohen për të shprehur pikëpamjet e tyre edhe përmes procedurës së shkruar;
 - 1.12. Aktivitetet teknike të Sekretarisë së komisionit sigurohen nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës në bashkëpunim me Divizionin e Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Ministritë përgjegjëse përkatësisht institucionet relevante emërojnë përfaqësuesit e tyre dhe njoftojnë Kryesuesin e Komisionit Punues për regjistrimin e bujqësisë.

Neni 5
Mandati

Komisioni e fillon punën menjëherë dhe mandati i tij përfundon më 28 shkurt 2014.

Neni 6
Zbatimi

Obligohen Institucionet nga neni 3 për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/119

Datë: 13.03.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në bazë të Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjeve për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2013, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare të kredisë në shumë prej 5,000.000.00 (pesë milion) euro për modernizimin e sistemit arsimor të Kosovës përmes mësimit elektronik dhe digjitalizimit të provimit të Maturës Shtetërore.
2. Obligohen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 06/119

Datë: 13.03.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2013, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Jashtme për themelimin e Konferencës së Diplomacisë "Gërmia Hill".
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/119

Datë: 13.03.2013


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2013, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për transfer të mjeteve në mes të ndarjeve buxhetore për vitin 2013 brenda kësaj ministrie, si vijon:
 - 1.1. Shuma prej 1,700,000 euro nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nën-programi Departamenti i Pagesave (me kod 474), transferohet në nën-programin e Administratës Qendrore (me kod 113) në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere;
 - 1.2. Shuma prej 176,800 euro nga kategoria mallra dhe shërbime, nga nën-programi i Shërbimeve Këshillimore (me kod 404), transferohet në nën-programin e Administratës Qendrore (me kod 113) në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime;
 - 1.3. Shuma prej 180,000 euro nga kategoria mallra dhe shërbime, nga nën-programi i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve (me kod 401), transferohet në nën-programin e Administratës Qendrore (me kod 113) në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime dhe
 - 1.4. Shuma prej 359,500 euro nga kategoria investime kapitale, nga nën-programi i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve (me kod 401), nga projekti "Rehabilitimi i sistemit të ujitjes", me kod 10027 transferohet në nën-programin e Administratës Qendrore (me kod 113) në kategorinë investime kapitale, projekti "Blerja e makinave".

2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë